

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT TIRANË**  
Nr. i Vendimit 6730/6

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë 18.03.2001, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, ~~Këshilli Administrativ~~ pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria “Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit të Kulturës” Sh.p.k., më poshtë referuar si “Shoqëria” e përfaqësuar nga Z. Klidi Baboçi, në cilësinë e drejtorit të Shoqërisë si dhe dokumentat e tjera bashkangjitur kërkesës,

**KONSTATOVA:**

Shoqëria “Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit të Kulturës” Sh.p.k. është regjistruar pranë kësaj Gjykate me Vendimin Nr. 6738, datë 15.09.1993. dhe ka si ortakë të saj Ministrinë e Kulturës, që zoteron 45% të kuotave të kapitalit themeltar, dhe si ortak tjetër Shoqerinë Italiane “DINVEST” S.p.a., e cila zoteron 55% të kuotave të këtij kapitali. Me vendime të mëtejshme është shitura pjesa e zotuar prej Dinvest S.p.a. tek “TECNOSYSTEM ENGINEERING” S.r.l; është emëruar drejtor i shoqërisë Z. Riccardo Porro dhe janë bërë ndryshime të herëpashershme në këshillin administrativ të Shoqërisë.

Më datë 18.03.2001 është mbledhur Këshilli Administrativ i shoqërisë me pjesmarjen e të gjithë anëtarëve për të diskutuar mbi rendin e ditës së mëposhtëm:

- 1 emërimi i drejtorit të ri të Shoqërisë.

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës iu njofua Këshillit Administrativ se drejtori Riccardo Porro ka lënë detyrën pasi është në pamundësi për t'a kryer atë. Më pas u propozua të emërohet Z. Klidi Baboçi në detyrën e drejtorit të Shoqërisë. Pas një diskutimi të hollësishëm, Këshilli Administrativ me unanimitet vendosi emërimin e Z. Baboçi në detyrën e drejtorit të shoqërisë.

**PËR KËTO ARSYE**

meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të plotësuara në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 28.01.1992, “Për Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjin Nr. 7632, datë 04.11.1992, “Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar,

**VENDOSA:**

- Pranimin e kërkesës së bërë nga Drejtori i Shoqërisë “Qendra Tregtare dhc e Zhvillimit të Kulturës” Sh.p.k, Z. Kliti Baboçi.
- Depozitim në Regjistrin Tregtar të Vendimit të Këshillit Administrativ të Shoqërisë për emërimin e drejtorit të Shoqërisë “Qendra Tregtare dhe e Zhvillimit të Kulturës” Sh.p.k.

Urdhërimin e zyrës së Regjistratit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë për të bërë ndryshimet përkatëse në këtë Regjistër.

Tiranë, më datë 18.03.2001.

GJYQTARE

*Agjze Shkabani  
Agjze Shkabani*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERE MIMOZA SHEHU  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr.Rep. ....46 35  
Nr.Kol .....1657



**VENDIM**

**I ASAMBLESE SE PERGJITHESHME TE ORTAKEVE  
TE SHOQERISE "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k.**

Viti 2011 (dymije e njembedhjete), data 12, e muajit maj, ne qytetin e Tiranes, ne adresen: Sheshi Skenderbej, Pallati i Kultures, ne oren 16.00,  
- perpara meje Noteres meje Noteres Mimoza Shehu, ne Tirane, anetare e Dhomes se Notereve Tirane,

**PARAQITET**

Zoti Klidi Baboci, lindur ne Tirane, me 23-07-1962, me banim ne Tirane, per identitetin e te cilit, une noterja jam e sigurte, ne baze se Kartes se Identitetit n.024650548, madhor, me zotesi te plete per te vepruar, i cili deklaron, se nderhyn ne kete akt, me cilesine e Administratorit te shoqerise "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k., me qender legale ne qytetin e Tiranes, ne adresen: Sheshi Skenderbej, Pallati i Kultures, me kapitalin themeltar prej leke 291.500.000,00 (dyqindenentedhjetene milion e peseqind mijë,00), te vendosur, te nenshruar e teresisht te derdhur, NIPT J618130360.


I paraqituri, me kerkon marrjen e redaktimin e ketij akti dhe deklaron sikunder ketu eshte mbledhur, asamblea e pergjitheshme e shoqerise se siper cituar "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k., ne zbatim te normatives se parashikuara nga ligji n.9901/2008, per te vendosur ne vijim, mbi

**RENDIN E DITES:**

- 1) Emerimi i administratoreve te shoqerise me nje mandat pese vjear;
- 2) Riformulimi i Statutit te shoqerise, me qellim pershatjen e tij me normativat e reja te parashikuara nga Ligji n.9901, date 14.04.2008 "per tregetaret dhe shoqerite tregetare".
- 3) Te delegoje zotin Klidi Baboci, per depozimin e regjistrimin e ketij vendimi te asamblese prane Qendres Kombetare te Regjistrimit – Tirana (AL).
- 4) Te ndryshme dhe eventuale.

Merr drejtimin e asamblese, ne zbatim te kerkesave te Statutit, Avv. Giovanni Degennaro, i cili fton noteren per te shkruar ne proces – verbal zhvillimin e kesaj asambleje dhe cakton si perkthyese zonjen Miranda Sauku.

Une, noterja, nderhyj dhe veproj, si vijon:

  
Kryesuesi deklaron:

- se, eshte i pranishem 55 % (pesedhjete e pese perqind) e kapitalit themeltar te shoqerise;
- se, eshte pjesemarres ne kete mbledhje te per gjitheshme, ne cilesine e perfaquesuesit te ortakut italian, zoti:

**1) Avv.Giovanni Degennaro**, ne cilesine e perfaquesuesit ligor dhe te Keshillit Administrativ te shoqerise italiane Tecnosystem Engineering s.r.l., qe perfaqeson 55 (pesedhje e pese perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise, qe vepron ne emer dhe per llogari te shoqerise italiane Tecnosystem Engineering s.r.l., ne baze te prokures se parashikuar nga asamblea e per gjitheshme e dates 15-04-2011;

- se, jane te pranishem nga organi administrativ, zoterinje:

Avv.Giovanni Degennaro, Kryetar,  
Zoti Vincenzo Pastoressa, Keshilltar efektiv,  
Dott. Klidi Baboci, Keshilltar efektiv dhe Drejtore Administrativ,

Te pranishmit deklarojne se njojin mire argumentet e sjella ne rendin e dites, te diskutuara me pare ne takime informale te zhvilluara ndermjet tyre.

*Kryesuesi Avv. Giovanni Degennaro ve ne dijeni asamblene, se eshte bere rregullisht, thirrja e asamblese se ortakeve te shoqerise "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k., sikunder vertetohet me thirrjen nr.07 prot., date 22-04-2011, te nenshkruar dhe vulosur per shoqerine nga Kryetari i Keshillit Administrativ, Avv.Giovanni Degennaro; depozituar dhe marre ne dorezim nga Sekretaria e Ministrise se Ekonomise, Tregetise dhe Energetikes, protokolluar me nr.3341, date 22-04-2011; megjithe perpjekjet e bera, per pjesemarrjen e perfaqueseses se Ortakut shteteror, kjo nuk u be e mundur te arrihej.*

*Ne keto kushte, Kryesuesi Avv. Giovanni Degennaro ve ne dijeni, gjithashtu, asamblene, se pasur ne kon siderate aresyet qe shpjegohen ne paragrafin e mesiperme, ne baze te ligjit nr.9901, date 14-04-2008 "per tregetaret dhe per shoqerite tregetare", nenin 86 n.1 ne kombinim me nenin 87 n.1, plotesohen te gjitha kushtet ligjore qe asamblea e thirrur dhe e mbajtur, edhe vetem me pjesemarrjen e ortakut italian, te shoqerise Tecnosystem Engineering s.r.l., e cila zoteron 55 perqind te kuatave ne kapitalin themeltar, te jete e vlefeshme per te marre vendime, per te gjitha problemet qe shtronhen ne rendin e dites.*

Kryesuesi hap punimet e asamblese dhe ne argument te pikes se pare te Rendit te dites, i shpjegon asamblese, se ligji n.9901, date 14-04-2008, i cili ka hyre ne fuqi me daten 21-05-2008, ka sjelle ndryshime thelbezore ne krahasim me ligjin e meparshem n.7638, date 19.11.1992, te cilin e ka shfuqizuar. Ne baze te nenit 230, te ligjit n.9901/2008, shoqerite tregetare, qe kane ekzistuar perpara hyrjes ne fuqi te ligjit te ri, jane te detyruara te pershtasin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitive te ligjit te ri, brenda tre vjeteve pas hyrjes ne fuqi te ligjit te ri; shoqerite tregetare qe nuk marrin masa per pershatjen e tyre, sipas normativeve se re, konsiderohen te prishura dhe cregjistrohen pas perfundimit te procedurave te likudimit.

Persa siper parashtruar, Kryesuesi, duke iu referuar ndryshimeve te Statutit te shoqerise "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k., shpjegon se ato behen te domosdoshme, ne kushtet dhe peraresyet, si vijon:

- se, disa dispozita te Statutit nuk jane me efektive, sepse e kane humbur kuptimin e tyre dhe nuk pasqyrojne me ne menyre besnike gjendjen shoqerore, juridike dhe pasurore te shoqerise "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k.,
- se, disa dispozita te Statutit, me kalimin e kohes, kane pesuar ndryshime teresore e pjesore dhe duhet te azhornohen me normativen e re te ligjit n.9901/2008;
- se, disa dispozita te Statutit parashikojne një discipline krejtësisht te ndryshme me normativen e re te ligjit n.9901/2008;
- se, duhet ndryshuar, per pasoje, pothuajse i gjithe formulimi i Statutit te shoqerise.

1) Duke kaluar ne shqyrtimin ne thelb te pikes se pare te Rendit te dites, Kryesuesi shpjegon, se bazuar ne ligjin nr. 9901/2008, Kapitulli II, shoqeria me perjegjesi te kufizuar nuk ka si organ administrativ – keshillin administrativ – por, një ose disa administratore - me një mandat jo me shume se pese vjetë (neni 95, n.1); ndersa administratoret e një shoqerie kontrolluese, nuk mund te emerohen si administratore te një shoqerie te kontrolluar dhe anasjlltas, duke konsideruar te pavlefeshme cdo emerim që vjen ne kundershtim me dispozitat e nenit 95 n.2, ne kombinim me nenin 207 te ligjit n.9901/2008.

Te drejtat dhe pushtetet e administratoreve rregullohen, ne baze te neneve 95, 96, 97, 98 te ligjit n.9901/2008 dhe nga dispozitat ne permbajtje te ketij vendimi te asamblese.

Me qenese, Avv. Giovanni Degennaro dhe Ing. Canio Scianatico janë administratore te shoqerise kontrolluese Tecnosystem Engineering s.r.l., ne respektim te nenit 95 n.2 te ligjit n.9901/2008 kane paraqitur doreheqjen nga detyra e administratoreve, duke mos mundur me te jene, si ne cilesine e administratoreve te shoqerise Tecnosystem Engineering s.r.l., shoqeri kontrolluese e shoqerise "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k., edhe administratore te shoqerise se kontrolluar "QENDRA TREGETARE E ZHVILLIMIT KULTUROR" sh.p.k.

Ne lidhje me kete, Kryesuesi komunikon se shoqeria Tecnosystem Engineering s.r.l., ne zevendesim te administratoreve Avv. Giovanni Degennaro dhe Ing. Canio Scianatico, ka emeruar Avv. Gianluca Degennaro dhe zonjen Miranda Sauku dhe, per pasoje, i propozon asamblese emerimin e organit te ri administrativ, me një kohezgjatje prej pese vjetesh, te perbere nga zoterinje:

- a) – **Avv.Gianluca Degennaro**, shtetas italian, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Bari, me 07-12-1976, mbajtes i pasaportes n.630943X, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise;
- b) – **Zoti Vincenzo Pastoressa**, shtetas italian, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Bitonto (Bari), me 23-02-1964, mbajtes i pasaportes n.Y 441550, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise;

c) – Dott. **Klidi Baboci**, shtetas shqiptar, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Tirane, me 23-07-1962, mbajtes i Kartes se Identitetit n.024650548, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise;

d) – Z.nja **Miranda Sauku**, shtetase shqiptare, madhore, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Tirane, me 11-09-1970, mbajtese e Kartes se Identitetit n.029605046, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise.

1) Duke kaluar ne shqyrtimin ne thelb te pikes se dyte te Rendit te dites, Kryesuesi propozon se eshte e domosdoshme te riformulohen aktet e shoqerise qe vijne ne kundershtim me normativen e re, te parashikuar nga ligji n.9901/2008, duke ruajtur te pandryshuara dispozitat vijuese: strukturen e ortakerise ne shoqeri te perbere prej dy ortakeve pjesemarres, emrin e shoqerise, qendren ligjore, kapitalin themeltar dhe perpjestimin e kuotave te ortakeve ne kapitalin themeltar dhe kohezgjatjen; te gjitha nenet e tjera te Statutit duhet te riformulohen, ne konformitet me normativen e re; pas kesaj ekspozeje, Kryesuesi kalon ne leximin e Statutit te ri, qe i propozon per aprovim asamblese.

Pas nje diskutimi te gjere dhe shpjegimeve te dhena nga Kryesuesi, asamblea e per gjitheshme, me mendimin e favorshem edhe te organit administrativ, me unanimitetet

VENDOSI

1)

- te emeroje, duke pasur parasysh doreheqjen e administratoreve Avv.Giovanni Degennaro dhe Ing. Canio Scianatico dhe caktimin nga shoqeria Tecnosystem Engineering s.r.l., si administratore, te Avv. Gianluca Degennaro dhe te zonjes Miranda Sauku, ne zevendesim te administratoreve Avv.Giovanni Degennaro dhe Ing.Canio Scianatico, administratore te rini me nje mandat me kohezgjatje prej pese vjete, zoterinjte, si vijon:

a) – **Avv.Gianluca Degennaro**, shtetas italian, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Bari, me 07-12-1976, mbajtes i pasaportes n.630943X, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise.

b) – **Zoti Vincenzo Pastoressa**, shtetas italian, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Bitonto (Bari), me 23-02-1964, mbajtes i pasaportes n.Y 441550, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise.

c) – **Dott. Klidi Baboci**, shtetas shqiptar, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Tirane, me 23-07-1962, mbajtes i Kartes se Identitetit n.024650548, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise.

d) – **Z.nja Miranda Sauku**, shtetase shqiptare, madhore, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Tirane, me 11-09-1970, mbajtese e Kartes se Identitetit n.029605046, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise.

- Administratoret jane te veshur me pushtetet me te gjera per administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise, pa pasur ndonje perjashtim te ndonje lloji te vecante dhe kane fakultetin per te

**PROCES VERBAL I ASAMBLESË SË ORTAKËVE**  
**QËNDRA TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR Sh.p.k.**  
**11.05.2016 - Tiranë**

Më 11.05.2016, në orën 11.00 në selinë e **QËNDRËS TREGTARE DHE ZHVILLIMIT KULTUROR Sh.p.k.**, në Pallatin e Kulturës, Tiranë - Sheshi Skenderbej u mblohd Asembleia e Ortakëve të Q.T.ZH.K.-së për të diskutuar e vendosur mbi pikat e rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Emërim i administratorëve në mbështetje të nenit 21 të Statutit të Shoqërisë.
2. Të ndryshme dhe eventuale.

Janë të pranishëm ortakët :

- Për Ortakun Italian, Tecnosystem Engineering S.r.l. e përfaqsuar nga Ing. Canio Scianatico që zotëron 55% të kapitalit shoqëror në Shoqërinë Q.T.ZH.K. Sh.p.k. i përfaqsuar nga Rag.Vito Tassiello me Prokure të Posaçme n. Repertori 33904, date 29 prill 2016.
- Për Ortakun shtetëror, Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit Tregëtisë dhe Sipërmarrjes që zotron 45% të kapitalit shoqëror në Shoqërinë Q.T.ZH.K. Sh.p.k. e cila përfaqësohet nga Z. Alban Beqaj me autorizimin date 09.05.2016 nr. 3428/1 prot. lëshuar nga Ministria Znj. Milva Ekonomi e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregëtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes,
- Janë të pranishëm administratorët e Shoqërisë Q.T.ZH.K. Sh.p.k. Z. Vincenzo Pastoressa, Z. Klidi Baboci dhe Znj.Miranda Sauku.

I ftuar nga të pranishmit merr drejtimin e Presidencës së Asembleës së Ortakëve Z. Vito Tassiello, i cili pasi konstaton praninë e të gjithë kapitalit shoqëror e deklaron të vlefshme mbledhjen e Asambleës së Ortakëve për të diskutuar e vendosur mbi argumentat e rendit të ditës e ngarkon Znj. Miranda Sauku të kryejë funksionin e sekretares e përkthyeses e cila pranon.

Para se të kalohet në trajtimin e rendit të ditës, përfaqësuesi i ortakut shtetëror, Z. Alban Beqaj u lexon të pranishëmve në asamblën e ortakëve letrën me nr. Prot. 3428/2 datë 09.05.2016 e firmosur nga Ministria Znj. Milva Ekonomi për qëndrimin e ortakut shtetëror në lidhje me argumentin sipas rendit të ditës në mbledhjen e sotme të asambleës, e cila protokollohet në aktet e Shoqërisë.

Në vijim të pikës së parë të rendit të ditës e merr fjalën një nga administratorët, Z.Vincenzo Pastoressa, i cili ilustron të pranishëmve tashmë të informuar për argumentin që me përfundimin e mandatit të administratorëve më 12.05.2016 dhe në bazë të nenit 21 të statutit të shoqërisë është thirur asembleia e ortakëve për emërimin e administratorëve te shoqërisë.

Në lidhe me këtë çështje e merr fjalën Presidenti Z. Vito Tassiello i cili nisur edhe nga qëndrimi i përfaqësuesit të ortakut shtetëror propozon rikonfirmimin në bazë të nenit 81. Paragrafi 1 pika 3 dhe nenit 95 paragrafi 2 i ligjit për 5 (pesë) vjet të tjera po të njëjtë administratorë që janë në fuqi,

Pas një diskutimi të shkurtër Asamblea e Ortakëve me unanimitet **vendosi** :

1.Të rikonfirmojë si administratorë të shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare referuar nenit 81 paragrafi 1 pika 3 dhe nenit 95 paragrafi 2 i ligjit zotérinjtë:

- a)- Avv.Gianluca Degennaro, shtetas italian, madhor, me perjegjesi të plete për të vepruar, lindur në Bari, me 07.12.1976, mbajtes i pasaportes n.630943X, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise;
- b)- Zoti Vincenzo Pastoressa, shtetas itaiian, madhor, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Bitonto (Bari), me 23.02.1964, mbajtes i pasaportes n.Y 441550, me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise;
- c)- Z. Klidi Baboci, shtetas shqiptar, madhor, me perjegjesi të plete per te vepruar, lindur ne Tirane, me 23.07.1962, mbajtes i Kartes se Identitetit n. G20723103I me vendqendrim te zgjedhur prane qendres se shoqerise të cilit i delegohet gjithashtu detyra e Presidentit në mbledhjet e Administratorëve.
- d)- Znj. Miranda Sauku, shtetase shqiptare, madhore, me perjegjesi te plete per te vepruar, lindur ne Tirane, me 11.09.1970, mbajtese e Kartës së Identitetit n. H05911089U, me vendqendrim te zgjedhur pranë qendres se shoqerise.

2.Të rikonfirmojë përfaqësimin ligjor të Shoqërisë nga zotérinjtë Klidi Baboci dhe Vincenzo Pastoressa për gjatë gjithë kohëzgjatjes edhe veç e veç ndaj të tretëve dhe në gjykim.

Për kryerjen e kësaj detyre vendoset gjithashtu të mos ketë ndryshime në kompensimin ndaj administratorëve duke konfirmuar ç'ka ju është njohur edhe në periudhën e më parëshme si dhe autorizohet z.Klidi Baboci të kryej regjistrimin e këtyre emërimeve në QKR.

Duke mos pasur gjë tjetër për të vendosur dhe pasi askush tjetër nuk e kërkon më fjalën, Presidenti pasi shpreh përgëzimet më të sinqerta dhe vlersimin e tij për punën e kryer nga administratorët e shoqërisë ratifikon kështu të gjithë veprimtarinë e tyre e të gjitha aktet e kryera dhe të finalizuara nga ata për aritjen e objektivave dhe në interes të shoqërisë dhe e deklaron mbylljen e mbledhjes së Asamblessë së Ortakëve në orën 12.30 duke lexuar paraprakisht dhe më pas duke e firmosur proçes verbalin e saj nga të pranishmit

Sekretare dhe Përkthyese

Miranda Sauku

Administratorët :

Z. Vincenzo Pastoressa

Z. Klidi Baboci

Znj. Miranda Sauku

ORTAKËT

Për TECNOSYSTEM ENGINNERING S.r.l.

Ing. CANIO SCIANATICO

Me Prokure Perfaqsimi

Z. VITO TASSIELLO

Për MINISTRINË E ZHVILLIMIT  
EKONOMISË TURIZMIT TREGTISE  
DHE SIPËRMARJES

Me Autorizim nga Ministria

Z. ALBAN BEQAJ